

NJOFTIM PËR SHTYP
KOMISIONI I SHOQËRISË CIVILE

Në institucionin e Avokatit të Popullit, janë zhvilluar mbledhjet e Komisionit Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile.

Pjesëmarrësit në mbledhje ishin, z. Gentjan Sejrani Kryetar, z. Rigels Xhemollari sekretar, z. Eduart Mazi, anëtar, znj. Ada Ilia, anëtare dhe z. Arbër Ademi, anëtar.

Të pranishëm në mbledhjet, me statusin e vëzhguesit ishin gjithashtu përfaqësuesit nga misioni OPDAT në Shqipëri, EU4Justice, OSCE dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Pas shqyrtimit të kandidaturave nga shoqëria civile për KLGJ dhe KLP, Komisioni duke vlerësuar informacionet e dosjeve dhe informacionet shtesë nga vetë kandidatët Komisioni vendosi:

1. Konstatimin e plotësisht të kushteve ligjore dhe kriterëve formale për kandidatët: Altin Hazizaj, Erion Fejzulla, Juelda Lamçe, Violanda Theodhori.
2. Konstatimin e mosplotësisht të kushteve ligjore për kandidatët: Altin Shegani, Andi Muratej, Edison Hoxha, Nertila Sadedini, Diana Dervishi, Lefterije Lleshi (Luzi), Nada Dollani.
3. Të njoftohen kandidatët e mësipërm në mënyrë individuale, ndërkohë që Vendimi i arsyetuar do ju dërgohet brenda një afati të arsyeshëm.

Mbledhja e radhës në intervistat me kandidatët e kualifikuar do të njoftohet në ditët në vijim.